

VENDIM
Nr. 91, datë 2.6.2020

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE, TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 87, DATË 19.5.2020, “PËR FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 402, SERIA P18, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 83, DATË 6.4.2018, “PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘FAVINA 1’ SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘VOSKOPOJË’, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1970 *kw*”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 64, 90 pika 3, 94, pika 1 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 87, datë 19.5.2020,

konstatoi se:

- Shoqëria “Favina 1” sh.p.k., me shkresën nr. 17 prot., datë 16.4.2020, protokolluar në ERE me nr. 650, datë 22.4.2020, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, “Për licencimin e shoqërisë ‘Favina 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Voskopojë’, me kapacitet të instaluar 1970 *kw*”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 87, datë 19.5.2020, vendosi për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, “Për licencimin e shoqërisë ‘Favina 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Voskopojë’, me kapacitet të instaluar 1970 *kw*”.

- Në datë 19.5.2020, në ERE, është depozituar shkresa e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. “Njoftim për anulimin e kërkesës për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, “Për licencimin e shoqërisë ‘Favina 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Voskopojë’, me kapacitet të instaluar 1970 *kw*”, nëpërmjet së cilës kërkon që ERE të mos marrë në konsideratë kërkesën për modifikimin e licencës së sipërcituar, pasi për shkak të kushteve të vështira të krijuara nga pandemia COVID-19, ndodhet në pamundësi financiare për të investuar shtesën e kapacitetit të instaluar të HEC-it “Voskopojë” nga 1970 *kw* në 2400 *kw*.

- Neni 64 i Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 2, parashikon se:

- Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dore nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj.

- Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative.

- Në pikën 1 të nenit 94 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 19.5.2020, “Për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, “Për licencimin e shoqërisë ‘Favina 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Voskopojë’, me kapacitet të instaluar 1970 *kw*”.

2. Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 87, datë 19.5.2020, “Për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 6.4.2018, “Për licencimin e shoqërisë ‘Favina 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Voskopojë’, me kapacitet të instaluar 1970 *kw*”, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti